

# Administrimi i konfliktit të interesit në shërbimin publik



Udhëzues

[www.coe.int/peck2](http://www.coe.int/peck2)

## Projekti kundër Krimet Ekonomik (PECK II)

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented  
by the Council of Europe

---

Funded  
by the European Union  
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

---

Implemented  
by the Council of Europe

**Projekti kundër Krimet Ekonomik në Kosovë\* (PECK II)**  
[www.coe.int/peck2](http://www.coe.int/peck2)

# **Udhëzues për administrimin e konfliktit të interesit në shërbimin publik**

---

\*Ky shënim nuk përbën asnjë paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të KS të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

## **Edicioni në gjuhën shqipe**

(I përkthyer nga gjuha angleze)

Botuar nga Këshilli i Evropës

F-67075 Strasbourg Cedex

[www.coe.int](http://www.coe.int)

© Këshilli i Evropës, Qershor 2019

Autori:

Valts Kalnins, Ekspert i Këshillit të Evropës

Kopertina dhe faqosja: Art Studio, Prishtinë

Shtypur nga Art Studio, Prishtinë

Tirazhi: 1000 kopje

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të përkthehet, riprodhohet ose transmetohet, në ndonjë formë ose me ndonjë mjet, elektronik (CD-Rom, internet, etj.) apo mekanik, përfshirë fotokopjimin, incizimin apo çfarëdo sistemi të ruajtjes ose të rikthimit të informacionit, pa lejen paraprake të lëshuar me shkrim nga Drejtoria e Komunikimeve (F-67075 Strasbourg Cedex apo [publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int))

Ky botim është përgatitur me ndihmën financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Qëndrimet e shprehura në të nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë pozitën zyrtare të Bashkimit Evropian dhe/ose të Këshillit të Evropës

Për më shumë informacion mbi temën e botimit, luteni të kontaktoni:

Divizioni për Bashkëpunim kundër Krimit Ekonomik

Departamenti për Veprim kundër Krimit

Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit

Këshilli i Evropës

Email: [contact.econcrime@coe.int](mailto:contact.econcrime@coe.int)

Internet: [www.coe.int/econcrime](http://www.coe.int/econcrime)

# PËRMBAJTJA

<b>1. PËRMBLEDHJE</b> .....	5
<b>2. HYRJE</b> .....	6
<b>3. TERMAT KRYESORË</b> .....	7
3.1. Konflikti i interesit .....	7
3.2. Konflikti real i interesit .....	8
3.3. Konflikti i mundshëm i interesit .....	8
3.4. Konflikti në dukje i interesit .....	8
3.5. Interesi privat .....	8
3.6. Personi i afërm me zyrtarin .....	9
<b>4. PËRCAKTIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT</b> .....	10
4.1. Konflikti i qartë i interesit .....	11
4.2. Rrethanat e dyshimta .....	11
4.3. Autotesti .....	14
4.4. Shembuj konflikti të mundshëm interesi .....	14
<b>5. ZGJIDHJA E KONFLIKTIT TË INTERESIT</b> .....	19
5.1. Zgjidhja rast për rast e konfliktit të interesit .....	19
5.2. Zgjidhja e konfliktit të interesit pas marrjes së detyrës së re .....	21
<b>6. PËRGJEGJËSITË E DREJTUESVE DHE INSTITUCIONEVE PUNËDHËNËSE</b> .....	23
6.1. Përgjegjësitë e drejtuesit .....	23
6.2. Detyrat kryesore të institucionit .....	23
<b>7. VEPRIMTARITË E JASHTME</b> .....	25
7.1 Rregullat e përgjithshme .....	25
7.2 Rregullat shtesë për zyrtarët e lartë .....	26
7.3 Shembuj të veprimtarive të jashtme .....	27
<b>8. DHURATAT</b> .....	31
8.1. Lista e kontrollit për dhuratat dhe bakshishet .....	32
<b>9. VEPRIMET KUNDËR NDIKIMIT NË VULLNETIN E ZYRTARIT</b> .....	33
<b>10. DETYRIMET DHE SANKSIONET E TJERA</b> .....	34
10.1. Veprimet e ndaluara .....	34
10.2. Transferimi i të drejtave të administrimit apo drejtimit të ndërmarrjes .....	34
10.3. Kufizimet pas punësimit .....	36
10.4. SankSIONET .....	36
<b>11. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME PËR PËRDORIMIN E UDHËZUESIT</b> .....	37
<b>12. BIBLIOGRAFIA</b> .....	38
<b>13. LISTA E SHTOJCAVE</b> .....	39

## SHKURTESAT

Agjencia	Agjencia e Kosovës kundër Korrupsionit
KI	Konflikti i interesit
PECK II	Projekti i përbashkët i BE/KiE kundër Krimit Ekonomik
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

## 1. PËRMBLEDHJE

Ky dokument teknik ofron udhëzime për administrimin e konfliktit të interesit në shërbimin publik, në bazë dhe në mbështetje të zbatimit të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik në Kosovë (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Ky udhëzues synon të lehtësojë pajtueshmërinë me legjislacionin për parandalimin e korrupsionit dhe t'i ndihmojë zyrtarët të ruajnë besimin e publikut në shërbimin që ofrojnë.

Udhëzuesi shpjegon termat kryesorë, si konflikti real, i mundshëm dhe në dukje i interesit, interesi privat pasuror dhe jopasuror, apo personi i afërm me zyrtarin. Një pjesë e rëndësishme e udhëzuesit u drejtohet zyrtarëve përkatës për të dalluar konfliktin e interesit. Pyetjet testuese i ndihmojnë zyrtarët të përcaktojnë nëse ka apo jo konflikt interesi. Shpjegimet e përgjithshme plotësohen me situata hipotetike ku sqarohet nëse përbëjnë apo jo konflikt interesi. Disa shembuj pasqyrojnë rrethana ku prania e konfliktit të interesit nuk është qartësisht e dallueshme në pamje të parë, ose kur zgjidhja e konfliktit është e ndërlikuar. Hapat kryesorë, procedurat dhe përgjegjësitë për zgjidhjen e konfliktit të interesit janë paraqitur si lista kontrolli dhe si grafikë. Për më tepër, janë rishikuar formularët ekzistues që duhet të përdoren nga zyrtarët, ose janë shtuar formularë të rinj aty ku është parë e nevojshme. Përveçse si material udhërrëfyes, udhëzuesi shërben edhe për rikujtim të disa dispozitave të përzgjedhura nga ligji.

Listat e kontrollit dhe shembujt e situatave hipotetike kanë për qëllim gjithashtu t'i udhëzojnë zyrtarët lidhur me veprimtaritë e jashtme të lejuara dhe të ndaluara në kontekstin e pozitës zyrtare. Shembujt paraqesin rrethana në të cilat zyrtarët mund të keqinterpretojnë kërkesat e ligjit dhe të arrijnë në përfundime të gabuara për lejueshmërinë e disa veprimtarive të jashtme. Ato tregojnë rrethana të zakonshme që hasen në praktikën ndërkombëtare, si dhe raste problematike të paraqitura nga palët e interesit të sektorit publik në Kosovë.

Ky udhëzues ndalet edhe te detyrimet e zyrtarëve në lidhje me dhuratat, kur përballen me përpjekjet për ndikim apo ushtrim ndikimi në vullnetin e tyre, te kërkesat për zyrtarët e lartë që të transferojnë të drejta administrimi apo drejtimi të ndërmarrjeve dhe te kufizimet në periudhën pas përfundimit të funksionit publik.

Ky udhëzues ofron shpjegime shtesë për vetë rregullimet e Ligjit. Prandaj, zyrtarët nxiten të konsultohen me ligjin sa herë gjenden në ndonjë konflikt të mundshëm interesi, apo kur përballen me ndonjë rrethanë kur aktet ligjore e përcaktojnë sjelljen. Rekomandohet që ky udhëzues të përditësohet sistematikisht, në mënyrë që të përshtatet me rrethanat e ndryshueshme të jetës reale. Agjencia kundër Korrupsionit dhe autoritetet e tjera duhet të shohin mundësinë e plotësimit të këtij udhëzuesi me mundësi trajnimi për zyrtarët në formën klasike në klasë dhe me trajnime online për çështje që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit. formë klasike në klasë dhe trajnime online për çështje që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit. 1,

## 2. HYRJE

Ky udhëzues është hartuar për t'iu ardhur në ndihmë zyrtarëve në mënyrë që ata të veprojnë në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit. Sipas Ligjit, çdo zyrtar publik dhe institucioni ku është i punësuar kanë përgjegjësinë parësore për administrimin e konfliktit të interesit. Agjencia kundër Korrupsionit zotohet të zgjidhë një konflikt interesi, vetëm pasi konstatohet se zgjidhja brendapërbrenda institucionit ose nga institucioni udhëheqës është e pamundur. Institucionet duhet të përcaktojnë gjithashtu rregullat e konfliktit të interesit në rregulloret e tyre të brendshme, ku mund të përdoren pjesë nga ky udhëzues.

Njohja dhe zgjidhja e duhur e konfliktit të interesit kërkon që zyrtarët të vlerësojnë themelin dhe të bëjnë gjykime të shëndosha lidhur me rrethanat që mund të duken të paqarta në pamje të parë. Gjithashtu, nevojitet aftësia për të vlerësuar me saktësi anë të ndryshme të rrethanave të dyshimta, për të vendosur me saktësi nëse një zyrtar mund të angazhohet dhe të përfshihet në veprimtari shtesë - përveç funksionit të vet publik - jashtë institucionit. Shpjegimet dhe udhëzimet e këtij udhëzuesi vlejné së pari për zyrtarët që në kompetencat e tyre profesionale nuk kanë parësore luftën kundër korrupsionit dhe legjislacionin për konfliktin e interesit. Ato përfaqësojnë një burim të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u përdorur si referim.

Tabelat paraqesin procedurat kryesore për zgjidhjen e konfliktit të interesit dhe reagimet e duhura ndaj ndikimit në vullnetin e zyrtarit. Lidhur me këto dhe tema të tjera, dokumenti shërben si kujtesë për detyrimet kryesore të zyrtarëve sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.


Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është themeli për pjesën më të madhe të udhëzimeve në këtë udhëzues. Sidoqoftë, sjellja në këtë fushë rregullohet edhe nga ligje e rregullore të tjera të brendshme të institucioneve. Prandaj, aty ku është e nevojshme, ky udhëzues iu referohet edhe ligjeve të tjera. Udhëzuesi pasqyron kornizën e përgjithshme dhe nuk synon të trajtojë në mënyrë shteruese rregullat specifike që zbatohen për kategori të caktuara zyrtarësh. Prandaj, zyrtarët inkurajohen ta përdorin këtë udhëzues si burim e parë të referimit, por duke verifikuar çdo herë nëse ka rregulla specifike të zbatueshme për ta për shkak të llojit të funksionit apo institucionit.

Udhëzuesi sqaron çështje dhe përmban shembuj që janë përmendur nga palët e interesit në seminarin e mbajtur në Prishtinë më 1 dhe 2 nëntor 2018. Versioni fillestar i udhëzuesit është diskutuar më tej me palët e interesuara më 6 dhe 7 dhjetor 2018. Udhëzuesi gjithashtu mbështetet tek rrethanat sfiduese të hasura në vende të tjera, që kanë sjellë rregullime të reja për konfliktin e interesit. Ky udhëzues i referohet në disa pjesë Udhëzuesit mbi Konfliktin e Interesit për Drejtuesit e Organizatave Publike që është përgatitur për projektin e Këshillit të Evropës "Kontrolli i korrupsionit përmes zbatimit të ligjit dhe parandalimit (CLEP)" në Republikën e Moldavisë në vitin 2017.

### 3. TERMAT KRYESORË<sup>1</sup>

#### 3.1 Konflikti i interesit


Konflikti i interesit ndodh kur një person ka një interes privat, i cili ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare (neni 6 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).



Konflikti i interesit nuk është konflikt ndërmjet individëve, roleve ose detyrave.

Kur interesi privat mund të cenojë mënyrën se si zyrtari i përmbush detyrat e veta, aty ka konflikt interesi. Ky është konflikt ndërmjet interesave private dhe publike.

Më poshtë shihni një shembull të konfliktit të interesit.



Detyra e zyrtarit është të përzgjedhë kandidatin për një vend të caktuar pune. Nëse vajza e tij/saj ka konkurruar, zyrtari duhet të deklarojë interesin privat dhe të tërhiqet nga vendimarrja.

Tërheqja është e nevojshme edhe kur vajza është kandidatja më e mirë. Arsyeja është se mund të lindin dyshime për paanshmërinë dhe objektivitetin e zyrtarit në këtë rethanë.

<sup>1</sup> Ky kapitull është përshtatur nga Udhëzuesi mbi Konfliktin e Interesit për Drejtuesit e Organizatave Publike, i përgatitur për Projektin e Këshillit të Evropës "Kontrolli i korrupsionit përmes zbatimit të ligjit dhe parandalimit (CLEP)" në Republikën e Moldavisë.



### 3.2 Konflikti real i interesit

Konflikti real i interesit lind kur interesi privat ndikon ose mund të ndikojë realisht në kryerjen e detyrave zyrtare në shërbim të interesit publik. Shembulli ku vajza e zyrtarit ka konkurruar për një vend pune përbën konflikt real interesi.

### 3.3 Konflikti I mundshëm i interesit

Konflikti i mundshëm i interesit shfaqet në rrethanat kur interesat private të zyrtarit mund të rezultojnë në konflikt real interesi. Me fjalë të tjera, interesi privat nuk ndikon në kryerjen e detyrave zyrtare për momentin, por ka gjasa të ndikojë në të ardhmen e parashikueshme.

Shembuj të konfliktit  
të mundshëm të interesit

- Kryearkitekti i një komune ka bashkëshorten administratore të një shoqërie të madhe ndërtimi në qytet.
- Meqë detyrat e arkitektit përfshijnë dhënie opinionesh për projektet e reja të zhvillimit, konflikti i mundshëm i interesit shëndrrohet në konflikt real interesi kur t'i kërkohet të shprehet për një projekt të hartuar nga shoqëria e bashkëshortes së tij.

### 3.4 Konflikti në dukje të interesit

Konflikti në dukje i interesit ndodh kur interesi privat i zyrtarit nuk ndikon ose nuk arrin të ndikojë në mënyrë të parregullt në kryerjen e detyrave zyrtare. Megjithatë, një person i jashtëm mund të ketë përshtypjen se ai ndikon.

Dukja e konfliktit të interesit duhet të mbështetet në fakte specifike, që paraqesin arsye të bazuara se përse mund të ndodhë konflikti i interesit. Nuk ka konflikt në dukje të interesit kur arsyet janë të paqarta dhe dyshimet janë të rrënjosura në mosbesimin e përgjithshëm te institucionet publike.

Shembull i konfliktit në  
dukje të interesit

- Një person ka shitur të gjitha aksionet që zotëronte te një shoqëri dhe është bërë zyrtar; një vit e gjysmë më vonë, i duhet të shqyrtojë një kërkesë të paraqitur nga shoqëria.

### 3.5 Interesi privat

Interesi privat është çdo përfitim që ka zyrtari, familja e tij/saj, të afërmit, miqtë dhe personat ose organizatat me të cilat ai ka apo ka pasur marrëdhënie pune (shih nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Interesat private mund të jenë pasurore (fitime ose humbje financiare apo materiale të tjera) dhe jopasurore (si marrëdhëniet personale, familjare ose marrëdhënie apo përfshirje të tjera).

Shembuj të interesave  
private pasurore

- Çdo lloj të ardhurash si paga apo përfitime nga një biznes ose veprimtari e jashtme.
- Përfitim si pasojë e dhënies së një kontrate të prokurimit publik.
- Çlirim nga përgjegjësia, si borxhi.

Shembuj të interesave  
private jopasurore

- Shmangie nga ndjekja penale.
- Akses në shërbime shëndetësore.
- Interesa politike, për shembull, sigurimi i një dhurimi për një parti politike ku zyrtari është anëtar.
- Dhënie e një dekorate.

### 3.6 Personi i afërm me zyrtarin

Personat e afërm me zyrtarin janë si në vijim:

- ✓ Bashkëshorti/ja ose partneri/ja bashkëjetues;
- ✓ Të afërmit në vijë të drejtpërdrejtë të gjakut pa kufizim;
- ✓ Të afërmit në vijë të tërthortë gjaku deri në shkallën e katërt;
- ✓ Birësuesi;
- ✓ I birësuari;
- ✓ Të afërmit nga ana e bashkëshortit(es) deri në shkallën e dytë;
- ✓ Çdo person fizik ose juridik që ka pasur ose ka interes të përbashkët privat pasuror ose jopasuror me zyrtarin.

Interesat private të personit të afërm mund të shkaktojnë konflikt interesit për një zyrtar njësoj si interesat private të vetë zyrtarit(es).

Personi juridik konsiderohet i afërm kur zyrtari ose anëtar i familjes ka marrëdhënie financiare aktuale ose të ardhshme me të, përfshirë marrëdhëniet kontraktore ose marrëdhëniet e punës ose dobi financiare të çfarëdolloj natyre (neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe neni 417 i Kodit Penal nr. 06/L-074).<sup>2</sup>

<sup>2</sup> Kodi i ri Penal nr. 06/L-074 pritet të hyjë në fuqi në mes të prillit 2019 (tre muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, më 14 janar 2019). Shih edhe nenin 424 të Kodit Penal ekzistues nr. 04/L-082, efektet e të cilit pushojnë pas hyrjes në fuqi të Kodit të ri Penal

Shembuj të personave fizikë që kanë interes të përbashkët me zyrtarin

- Person me të cilin zyrtari ka në bashkëpronësi një shoqëri.
- Shok klase i zyrtarit ose ish-shok klase me të cilin zyrtari është në kontakte të rregullta.
- Mik me të cilin zyrtari mban kontakte të rregullta.
- Avokati ose mjeku privat i zyrtarit.
- Mbikëqyrës i zyrtarit në punën e tij të jashtme.
- Ish-punëdhënës nga sektori privat i zyrtarit për një periudhë kohe që nga ndërprerja e asaj marrëdhënieje pune.
- Një person me të cilin zyrtari ka fëmijë të mitur.
- Bashkëshort/e i/e divorcuar së paku për një periudhë kohore.

Një zyrtar mund të pyesë veten se për sa kohë që nga mbarimi i shkollës, ndërprerja e marrëdhënies së punës ose divorci, ish-shokët apo partnerët cilësohen persona të afërm. Si pikë referimi mund të merret periudha kohore prej pesë vitesh. Për pesë vite, zyrtari e ka të ndaluar të ndërmarrë veprime që i përshtaten interesit të personave në lidhje të mëhershme biznesi (neni 9, nënparagrafi 1.8 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Kundërshtari i zyrtarit, për shembull, personi ndaj të cilit zyrtari ka një çështje gjyqësore civile, nuk ka interesa të përbashkëta me zyrtarin. Interesat e këtyre dy personave janë të kundërta. Sidoqoftë, gjatë vendimmarrjes apo veprimeve që kryen, zyrtari ka të ngjarë të ketë interes privat të kundërt me kundërshtarin. Ky interes ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrave zyrtare.


#### 4. PËRCAKTIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT<sup>3</sup>

Nëse filloni të dyshoni se konflikti i interesit mund të ndodhë ose mund të ketë ndodhur, duhet t'u përgjigjeni dy pyetjeve:

- ✓ A keni interes privat (pasuror apo jopasuror) në këtë rrethanë?
- ✓ A ndikon, mund të ndikojë ose a duket se ndikon interesi privat në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrave tuaja zyrtare?

Ekziston një marrëdhënie e dyanshme midis interesave publikë dhe privatë. Nëse kryerja e detyrave zyrtare mund t'i sjellë përfitim ose dëm interesit privat, interesi privat mund të ndikojë në kryerjen e detyrave.

<sup>3</sup> Hyrja në këtë pjesë, nënkapitulli 3.1 dhe 3.2 janë përshtatur nga Udhëzuesi mbi Konfliktin e Interesit për Drejtuesit e Organizatave Publike të përgatitur nga Projekti i Këshillit të Evropës "Kontrolli i korrupsionit përmes zbatimit të ligjit dhe parandalimit (CLEP)" në Republikën e Moldavisë në vitin 2017.



#### 4.1 Konflikti i qartë i interesit

Disa ndikime mbi interesin privat dhe konfliktet e interesit përkatëse janë të qarta. Kjo ndodh për shembull kur veprimet e zyrtarit mund t'i sjellin përfitime financiare vetë zyrtarit, bashkëshortit(es) të tij (saj), të afërmeve ose personave të tjerë në marrëdhënie me të.

Shembuj të konfliktit të qartë të interesit

- Veprime zyrtare në lidhje me kontratat e prokurimit, qiradhënien etj... me një subjekt juridik ku bashkëshortja ose një person tjetër i afërm i zyrtarit është themelues, drejtues ose ka marrëdhënie të tjera financiare.
- Mbikëqyrja ose kontrolli i një shoqërie ku është i/e punësuar një anëtar i familjes.
- Vendimi për të punësuar një të afërm, caktimi i pagës, shpërblimit ose pushimit të një të afërmi; mbikëqyrja e një të afërmi.
- Të gjitha më lart në lidhje me vetë zyrtarin.

Kur dalloni një interes privat të qartë dhe perceptoni qartë se kryerja e detyrave zyrtare mund t'i sjellë përfitime ose dëme interesit privat, duhet ta trajtoni rrethanën si konflikt interesi.

#### 4.2 Rrethanat e dyshimta

Lloje të ndryshme interesash private mund të ndikojnë në kryerjen e detyrave në mënyra të ndryshme. Jeta e përditshme mund të sjellë një shumëllojshmëri rrethanash që nuk mund të renditen në mënyrë shteruese në një listë konfliktesh interesi. Herët a vonë, do të përballeni me rrethana ku nuk jeni të sigurt nëse ka apo jo konflikt interesi.

Shembuj ku ndikimi  
i interesit privat  
është i dyshimtë

- Inspektori bën inspektimin e një supermarketi ku punon shoku i djalit të tij.
- Zëvendësudrejtori ka pranuar për nënshkrim një projektvendim për të zgjidhur kontratën e qiradhënies për një ambient ku mjeku i fëmijëve të vet ushtron praktikën private.
- Anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave në një procedurë prokurimi i ka para borxh njërit prej ofertuesve.

Për të vlerësuar rrethanat e dyshimta në të cilat duhet të përmbushni detyrat publike, tregohuni pragmatikë dhe përgjigjuni pyetjeve në vijim:

### PYETJE TESTUESE LIDHUR ME KONFLIKTIN E INTERESIT

- A mendoni se një person i zakonshëm që kupton mirë funksionimin e institucioneve publike do të dyshonte në aftësinë tuaj për të shqyrtuar çështjet e personave të përfshirë me paanshmëri dhe objektivitet?
- A mund të keni ju ose një person i afërm me ju përfitime që mund të ngrinin dyshime mbi paanshmërinë tuaj në këtë rast?
- A mundeni ju ose një person i afërm me ju të humbisni diçka?
- A mendoni se jeni disi i varur nga dikush që është përfshirë në këtë rast?
- A mendoni se një person i afërm me ju varet nga dikush i përfshirë në këtë rast?
- A keni një lidhje të fortë emocionale ose armiqësi me dikë të përfshirë në këtë rast?

Nëse përgjigja juaj për ndonjërin nga këto pyetje është "po", trajtojeni rrethanën si konflikt interesi. Nëse të gjitha përgjigjet janë "jo", atëherë duhet t'u përgjigjeni disa pyetjeve shtesë (të renditura më poshtë), për të verifikuar nëse ka konflikt në dukje ose konflikt të mundshëm interesi.

Për të identifikuar konfliktin në dukje të interesit, sërish tregohuni praktikë dhe përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

### PYETJE TESTUESE LIDHUR ME KONFLIKTIN NË DUKJE TË INTERESIT

- A mendoni se vetëm në bazë të informacionit të disponueshëm për publikun, një person i zakonshëm që kupton mirë funksionimin e institucioneve publike do të dyshonte në aftësinë tuaj për të kryer detyrat tuaja me paanshmëri dhe objektivitet?
- A mendoni se vetëm në bazë të informacionit të disponueshëm për publikun, një person i tillë do të besonte se ju mund të ndikoni në ndonjë rast, i cili sjell përfitime ose dëme për interesin tuaj privat ose atë të një personi të afërm me ju?
- A do të preferonit ta fshihnit këtë rrethanë rreth jush dhe institucionit tuaj, nëse një përfaqësues i mediave të respektuara ju pyet për të?
- A do të shqetësoheshit nëse situata do të zbulohet në publik?

Nëse përgjigja është "po" për cilëndo nga pyetjet, konsiderojeni rrethanën si konfliktë dukje të interesit.

Ndërkohë, kini parasysh se konflikti në dukje i interesit është specifik. Kështu, vetëm mosbesimi i përgjithshëm apo dyshimi i bazuar në rrethana të rastësishme nuk përbëjnë konflikt interesi. Për shembull, në një procedurë prokurimi, mund të rastisë që një anëtar i komisionit të vlerësimit të ofertave mund të ketë mbimër të njëjtë me një ofertues; kjo rrethanë nuk përbën asnjë lloj konflikti interesi, përveçse nëse personat kanë ndonjë marrëdhënie tjetër.

Për të identifikuar një konflikt të mundshëm interesi, përgjigjuni pyetjes në vijim:

### **PYETJE TESTUESE LIDHUR ME KONFLIKTIN E MUNDSHËM TË INTERESIT**

- A besoni se konflikti real i interesit nuk ekziston për momentin, por mund të lindë në të ardhmen?

Nëse përgjigja është "po", shqyrtojini rrethanën e konfliktit të mundshëm të interesit.

Për fusha specifike me rrezik të lartë korrupsioni, mund të përdoren pyetje testuese shitesë. Meqë prokurimi cilësohet si një prej fushave me rrezikun më të lartë, gjeni më poshtë disa pyetje shitesë që këshillohen për këtë fushë. Ato vlejné në çastin kur një institucion dëshiron të zbatojë një standard më të rreptë të konfliktit të interesit sesa normalisht, në procedura të tjera.

### **PYETJE TESTUESE SHITESË LIDHUR ME KONFLIKTIN E INTERESIT NË PROKURIMIN PUBLIK**

- A mundet që përjashtimi apo ndonjë veprim tjetër i pafavorshëm për cilindo nga pjesëmarrësit në prokurim, të jetë i favorshëm për ju apo një person të afërm me ju?
- A përfiton ju apo ndonjë person i afërm me ju nga një biznes që ofron mallra apo shërbime të llojit që do të prokurohet në këtë procedurë?
- A keni komunikuar së fundmi veçmas me ndonjërin prej pjesëmarrësve në prokurim, aq shumë dhe aq miqësisht (ose armiçësisht), sa që një person i zakonshëm me njohuri të mira për funksionimin e institucioneve publike do të dyshonte në aftësinë tuaj për ta trajtuar pjesëmarrësin në mënyrë të barabartë me të tjerët?
- A jeni konsultuar veçmas me ndonjërin prej pjesëmarrësve në prokurim, se si duhet përgatitur ose zhvilluar kjo procedurë e prokurimit?
- A keni diskutuar së fundmi me ndonjërin prej pjesëmarrësve në prokurim për mundësi të ardhshme punësimi për ju apo një person të afërm me ju?
- A është njëri prej pjesëmarrësve në prokurim sponsor i ndonjë partie politike ose kandidati me të cilin ju jeni apo keni qenë së fundmi i angazhuar politikisht si mbajtës i një posti politik, si anëtar ose çfarëdo tjetër?

Nëse përgjigja për ndonjërin prej këtyre pyetjeve më lart është "po", trajtojini rrethanën si konflikt në dukje të interesit.

### 4.3 Autotest<sup>4</sup>

Për të zbuluar çfarëdo konflikte të interesit, ju mund të plotësoni testin në vijim. Për të arritur rezultate objektive, duhet t'u përgjigjeni pyetjeve me sinqeritet, duke mos gënjer veten. Për lehtësi, krijoni një dokument të thjeshtë elektronik në Word, Excel apo në ndonjë format tjetër të përshtatshëm me tabelën më poshtë.

#### Modeli i autotestit

Lista e detyrave tuaja zyrtare të parashikuara me ligj, rregullore, kontratë punësimi, përshkrim të vendit të punës, etj.	Lista e interesave private që ndërliken në çfarëdo mënyre me sferën e detyrave tuaja zyrtare	Ndikimi i interesit privat	Ndikimi i interesit privat si perceptohet nga publiku	Ndikimi i pritshëm i interesit privat në të ardhmen
		Konflikti real i interesit	Konflikti në dukje i interesit	Konflikti i mundshëm i
1.	1.			
2.	2.			
3.	3.			
...shto rreshta sipas nevojës	...shto rreshta sipas nevojës			

### 4.4. Shembuj konflikti të mundshëm interesi<sup>5</sup>

#### 4.4.1 Situata 1

Një vajzë është diplomuar në drejtësi. Babai i saj është drejtor i departamentit rajonal në një institucion administrativ. Departamenti ka një vend të lirë për jurist dhe vajza është e gatshme të kthehet në qytet dhe të fillojë punë aty. Ajo aplikon për vendin e punës, por babai i saj është personi që merr vendimet për punësimet në atë departament. A ka ndonjë mënyrë të pranueshme për të dy të afërmit të punojnë në të njëjtin departament?

Kjo është një **rrethanë e një konflikti interesi**.

Drejtori e ka të ndaluar kategorikisht të kryejë detyra zyrtare që kanë ndikim tek e bija. Një zyrtar më i lartë ose institucioni udhëheqës (njësia qendrore e institucionit) mund ta zgjidhë këtë konflikt interesi, duke marrë përsipër vendimmarrjen në fazën e rekrutimit.

Pas emërimit të vajzës së drejtorit, shfaqet një konflikt i mundshëm interesi, sidomos nëse departamenti është i vogël me vetëm dy nivele hierarkie (drejtori dhe vartësit). Është e sigurt se në të ardhmen e afërt do të lindë një konflikt real interesi.

<sup>4</sup> Autotesti mbështetet në idenë e një metode të ngjashme në Rekomandimet metodologjike për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit të Agjencisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit të Ukrainës (miratuar më 29 shtator 2017).

<sup>5</sup> Disa nga shembujt janë përshatur nga Udhëzimi mbi Konfliktin e Interesit për Drejtuesit e Organizatave Publike të përgatitur për Projektin e Këshillit të Evropës "Kontrolli i korrupsionit përmes zbatimit të ligjit dhe parandalimit (CLEP)" në Republikën e Moldavisë në vitin 2017.

Për të shmangur konfliktin, është e nevojshme të ketë së paku një nivel të ndërmjetëm në hierarki ndërmjet dy të afërmeve. Kini parasysh se institucionet mund të kenë rregullat e tyre të brendshme lidhur me punësimin e të afërmeve. Për shembull, disa institucione e kanë të ndaluar që dy të afërm të punojnë në të njëjtin departament.

#### 4.4.2 Situata 2

Drejtesi i një institucioni të madh dëshiron të emërojë zëvendësin e vet dhe konstaton se kandidati më i kualifikuar për postin është bashkëthemeluesi i shoqërisë private të drejtuesit. A ka ndonjë mënyrë të ligjshme për ta emëruar këtë person, pa shkelur rregullat për konfliktin e interesit?

Kjo është një **rrethanë e konfliktit të interesit**.

Ligjërisht, ky emërim është i pamundur. Bashkëthemeluesit në shoqëri qartazi kanë interes në zhvillimin e biznesit dhe shtimin sa më të madh të përfitimeve, prandaj, drejtuesi do të ishte në shkelje të ushtrimit të detyrës publike, nëse emëron bashkëthemeluesin.

Konflikti i interesit në aktin e emërimit mund të administrohet duke vënë në lëvizje një zyrtar më të lartë ose Agjencinë kundër Korrupsionit, nëse nuk ka epur të drejtpërdrejtë. Çdo drejtues dhe zëvendësi i vet kanë marrëdhënie varësie të drejtpërdrejtë, gjë që ndalohej prej rregullave për konfliktin e interesit. Konflikti i interesit do të zgjidhej nëse personi emërohet si zëvendës vetëm pas dorëheqjes së drejtuesit dhe/ose transferimit të tij në një post tjetër. Sidoqoftë, largimi i një drejtuesi me qëllim që si zëvendës i tij të punësohet një person i caktuar është zakonisht i pamundur në praktikë.

#### 4.4.3 Situata 3

Një person ka aplikuar për një pozicion pune pranë departamentit të planifikimit në një ministri. Gjyshi i aplikuesit është drejtuesi i departamentit të furnizimit të asaj ministrie. Gjyshi nuk është i përfshirë as në komisionin përzgjedhës dhe as në vendimmarrjen lidhur me kandidatët. Nëse punësohet, aplikuesi nuk do të jetë vartës i gjyshit. Sidoqoftë, kryesuesi i komisionit përzgjedhës shqetësohet se dikush mund të mendojë se drejtuesi i departamentit të furnizimit ka ndikuar në përzgjedhje dhe rekrutimi do të konsiderohej si konflikt në dukje interesit.

Kjo nuk është **rrethanë e konfliktit të interesit**.

I afërmi (gjyshi) nuk ka dhe nuk pritet të ketë ndonjë fuqi vendimmarrëse mbi punonjësin e ri. Edhe për një konflikt interesi në dukje, duhet të ekzistojë një tregues specifik më i qartë i ndikimit të interesit privat.

#### 4.4.4 Situata 4

Anëtar i komisionit për vlerësimin e ofertave në një prokurim zbulon se një kushëriri i vet ka dorëzuar një ofertë.



#### Kjo është **rrethanë konflikti interesi**.

Kushëri i një zyrtari është person i afërm me zyrtarin. Përveç procedurave për zgjidhjen e konfliktit të interesit të përcaktuara me ligj, zyrtari duhet të marrë parasysh Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik (në fuqi nga 16 prilli 2018), që parashikon se: "Në rast se një anëtar i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave konstaton se ai/ajo ka një konflikt interesi në vlerësimin e tenderit, ai/ajo duhet të deklarojë interesin e vet në tender dhe të largohet nga takimi dhe nuk do të marrë pjesë më tej në procesin e vlerësimit në lidhje me veprimtarinë në fjalë. Individit që nuk merr pjesë në vlerësim, vazhdon të mbetet i betuar ende për konfidencialitetin."<sup>6</sup>

#### **4.4.5 Situata 5**

Një person ka aplikuar për pozitë zyrtare në institucionin për mbrojtjen e mjedisit. Pak para se të fillojë detyrën zyrtare, kandidati ia shet aksionet e veta të një shoqërie që merret me qiradhënie të automjeteve një personi të cilin nuk e njeh personalisht. Disa muaj më vonë, institucioni hap procedurën e prokurimit për shërbime të automjeteve me qira. Meqë zyrtari në fjalë ka njohuri për këto shërbime, ai është anëtar i komisionit për vlerësimin e prokurimit. Më vonë, zbulohet se ish-shoqëria ku ka pasur aksione ka dorëzuar ofertë në tender.

#### Ky është **konflikt interesi në dukje**

Një person i jashtëm mund të dyshojë se zyrtari ka lidhje personale me ofertuesin, edhe pse këto lidhje nuk ekzistojnë. Mund të krijohet perceptimi se çmimi për shitjen e biznesit ka qenë i ekzagjeruar, me qëllim që të krijohen marrëdhënie biznesi me institucionin publik në të ardhmen. Për më tepër, zyrtari e ka të ndaluar të ndërmarrë veprime që i përshtaten interesit të personave në lidhje të mëhershme biznesi në pesë vitet e fundit (neni 9, nënparagrafi 1.8 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Zyrtari duhet ta deklarojë interesin e tij/saj siç parashtrohet në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik dhe nuk duhet të marrë pjesë në procesin e mëtejshëm të vlerësimit.

#### **4.4.6 Situata 6**

Një familje ka një biznes privat që ofron shërbime udhëtimi. Një nga bashkëshortët dëshiron të nisë karrierën në shërbimin civil dhe pranohet si drejtues i një njësie në një ministri. Ministria prokuron herë pas here shërbime nga agjenci udhëtimesh. A ka të drejtë shoqëria e familjes të aplikojë në tenderë të shpallur nga ministria?

Po, një shoqëri mund të aplikojë në tender edhe nëse bashkëpronari i vet shërben në institucionin blerës si zyrtar jo i lartë. Sipas Ligjit nr. 04/L-04 për Prokurimin Publik, konflikti i interesit paraqitet nëse shërbyesi civil përfshihet në kryerjen e procedurës së prokurimit ose nëse është në gjendje të ndikojë në rezultatit e procedurës. Në këtë rast, shërbyesi civil duhet të deklarojë konfliktin e interesit, siç parashihet në ligj dhe në rregulla.

<sup>6</sup> Shih Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, paragrafi 40.15. Gjetendet në gjuhën shqipe në: <https://krpp.rks-gov.net>

Sidoqoftë, kjo rrethanë mund të konsiderohet si konflikt në dukje i interesit edhe nëse shërbyesi civil, me këtë interes privat, nuk është i përfshirë në procedurë. Konflikti në dukje i interesit është i pranishëm edhe kur shërbyesi civil përfshihet në procedura të ngjashme prokurimi ose duket se mund të ndikojë apo është në gjendje të ndikojë në procedurë, falë marrëdhënies së afërt me shërbyesit civilë të ngarkuar me këtë procedurë. Rekomandohet që ministria të miratojë në Rregulloren e Brendshme përkufizimet për llojet e rrethanave që cilësohen si konflikt në dukje i interesit.

#### **4.4.7 Situata 7**

Arkitekti i një komune pranon për nënshkrim një akt për modifikimin e planit të detajuar të një ngastre në pronësi të një ortakut nga ish-studio e arkitekturës. Arkitekti ia ka shitur pjesën e vet në këtë studio ortakut rreth një vit më parë. Sidoqoftë, edhe pas kësaj, ai ende është konsulent në përgatitjen e dy projekteve për studion.

Ky është së paku **konflikt interesi në dukje**.

Shitja e aksioneve sigurisht që ka kufizuar interesin privat të arkitektit në këtë studio. Por, duket se kanë mbetur ende disa lidhje të caktuara shoqërore dhe biznesi. Të dy ortakët kanë pasur marrëdhënie interesi për sa kohë kanë zotëruar të njëjtën studio dhe përfshirja e vazhduar e arkitektit të komunës në projekte e bën te besueshme se marrëdhënia e tyre vazhdon. Për më tepër, përfshirja në projekte krijon mundësi për të fituar të ardhura shtesë në të ardhmen. Arkitekti duhet të bëjë deklarin rast pas rasti të interesave private.

#### **4.4.8 Situata 8**

Drejtuësja e departamentit të planifikimit urban të komunës është e martuar me drejtorin ekzekutiv të një shoqërie të madhe ndërtimi. Drejtuësja vazhdimisht nënshkruan plane hapësinore të qytetit dhe ndryshimet e tyre. Deri tani, nuk ka pasur asnjë rast ku të nënshkruajë ndonjë plan me kërkesë të shoqërisë së bashkëshortit, apo plane që ndikojnë në projektet e hartuara nga shoqëria e ndërtimit.

Ky është **konflikt i mundshëm interesi**.

Drejtuësja e departamentit duhet të ndërmarrë hapa për të shmangur konfliktin e interesit, duke njoftuar eprorin ose institucionin udhëheqës/mbikëqyrës. Ajo dhe eprori duhet të diskutojnë mbi situatën dhe të ndërmarrin hapa kur miratimi i një plani ndikon realisht në projektin e përgatitur nga shoqëria.

Komuna duhet të miratojë rregullore të brendshme ku specifikon rregullat për format e konfliktit të interesit. Nëse konflikti i mundshëm i interesit shndërrohet shpesh në konflikt real interesi, interesat private ose detyrat publike të zyrtarit duhet të ripërshtaten (neni 19 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

#### **4.4.9 Situata 9**

Bashkëshortja e drejtuesit të autoritetit për sigurinë ushqimore është zëvendëskryetare e Shoqatës së Prodhuesve të Bulmetit. Institucioni publik inspekton ndërmarrjet që janë anëtare të shoqatës. Përfaqësuesit e shoqatës takohen shpesh me zyrtarët e autoritetit për sigurinë ushqimore dhe ministrinë mbikëqyrëse për të diskutuar mbi praktikën e inspektimeve dhe politikat për sigurinë ushqimore.

#### Ky është **konflikti i mundshëm interesit**.

Personat e afërm me zyrtarin janë bashkëshortja e tij dhe Shoqata e Prodhuesve të Bulmetit, sepse bashkëshortja ka marrëdhënie financiare atje. Për sa kohë drejtuesi i autoritetit i kryen detyrat zyrtare i pandikuar nga interesat e bashkëshortes ose të shoqatës, nuk ka konflikt real interesit.

Megjithatë, drejtuesi përcakton përparësitë dhe drejtimin e punës së autoritetit, rishikon ankesat administrative ndaj rezultateve të inspektimit dhe merr pjesë në hartimin e politikave në fushën e sigurisë ushqimore. Prandaj, veprimet e tij mund të ndikojnë në interesat e biznesit të disa anëtarëve të shoqatës dhe rrjedhimisht në suksesin e bashkëshortes në çuarjen përpara të interesave të anëtarëve të shoqatës. Pra, drejtuesi gjendet në konflikt të mundshëm interesit.

Ai duhet ta deklarojë këtë interes tek eprori ose tek institucioni udhëheqës/mbikëqyrës. Meqenëse ai është drejtuesi i institucionit, institucioni mbikëqyrës me siguri nuk është në gjendje të rishikojë apo të ndryshojë detyrat dhe kompetencat e zyrtarit për të shmangur konfliktin e mundshëm të interesit. Për të shmangur nevojën e zgjidhjes së konflikteve të shpeshta reale të interesit, duhet të shihet mundësia e transferimit të tij në pozitë tjetër. Alternativa tjetër është që bashkëshortja të heqë dorë nga puna në shoqatë.

#### **4.4.10 Situata 10**

Institucioni shpërndan subvencione dhe grante. A mundet zyrtari i institucionit të aplikojë për subvencion ose grant?

Përgjithësisht, zyrtari i një institucioni nuk e ka të ndaluar të aplikojë për subvencione ose grante që shpërndahen nga institucioni ku punon. Në rastin konkret, përgjigjja varet së pari nga karakteri i subvencionit ose grantit. Nëse është subvencion që i garantohet me ligj një subjekti (p.sh. fermë) që përbush kriteret, zyrtarit nuk mund t'i mohohet e drejta e aplikimit.

Nëse është grant që ofrohet vetëm për aplikues të përzgjedhur, për shembull, gjatë një konkursi, institucioni mund të përjashtojë zyrtarët e vet si të papranueshëm në bazë të rregulloreve të veta, me qëllim parandalimin e konfliktit të interesit. Në rastin e një zyrtari të lartë, ekziston ndalimi që ndërmarrja e tij/saj të përfitojë ndihmë nga institucioni ku punon zyrtari (neni 13, paragrafi 3 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Kur zyrtarit i lejohej të aplikojë, përgjegjësia bie mbi zyrtarët e tjerë të institucionit që të parandalojnë, shmangin dhe zgjidhin konfliktin e interesit. Vendimmarrësit nuk duhet të varen tek aplikuesi. Nëse ata nuk varen tek aplikuesi, pra nuk janë vartësit e tij/saj, gjasat për konflikt të interesit ulen dukshëm. Vendimet duhet të merren nga zyrtarët që nuk janë vartës të aplikuesit, të cilët punojnë në njësi të tjera dhe nuk kanë marrëdhënie personale të posaçme me të.

Nëse nuk ka vendimmarrës të tillë, kur aplikuesi është drejtues i institucionit, vendimmarrësit duhet të bëjnë deklarin rast për rast të interesave private. Nëse këto deklarata pranohen nga aplikuesi në cilësinë si drejtues, çështja duhet t'i drejtohet Agjencisë kundër Korrupsionit.

Institucioni mund të kufizojë perceptimin e konfliktit në dukje të interesit, duke fuqizuar qartësinë dhe transparencën e procedurave lidhur me shpërndarjen e subvencioneve ose granteve si dhe duke miratuar rregullore të brendshme.

#### 4.4.11 Situata 11

Grupi punues i ekspertëve (i përbërë nga zyrtarë dhe jozyrtarë) është krijuar në nivel të lartë të organit ekzekutiv për të hartuar standarde për llojet e programeve kompjuterike që duhet të përdorin institucionet publike. Standardet janë të nevojshme, sepse mundësojnë përputhshmëri të ndërsjellë mes programeve të institucioneve të ndryshme. Ndërkohë, një nga efektet e standardeve mund të jetë që disa prodhues dhe shitës programesh të jenë në gjendje të furnizojnë institucionet publike, ndërsa të tjerë jo. Disa ekspertë apo persona të afërm me ta, mund të kenë interesa biznesi apo përfitime nga disa shoqëri si ofruese shërbimesh.

Organi që ka krijuar grupin punues duhet t'u kërkojë ekspertëve të deklarojnë interesat e tyre dhe interesat e personave të afërm me ta, që mund të ndikohen nga standardet e hartuara nga grupi punues.

Nëse kanë interesa të tilla, anëtarët e grupit punues që janë zyrtarë duhet të paraqesin deklarin rast pas rasti të interesave private në përputhje me ligjin, meqë veprimtaria e grupit punues ka gjasa të ndikojë në vendimet e mëtejshme që merren për standardet.

Rregulloret e brendshme duhet të parashikojnë zgjidhjen e të gjitha konflikteve të interesit, duke përjashtuar një anëtar nga grupi punues apo nga etapa të caktuara të punës.

Po kështu, institucionet duhet të administrojnë të gjitha rastet e konfliktit të interesit që shfaqen gjatë proceseve të hartimit dhe zhvillimit të politikave.

## 5. ZGJIDHJA E KONFLIKTIT TË INTERESIT

### 5.1 Zgjidhja rast për rast e konfliktit të interesit

(Neni 17 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Nëse jeni në dijeni se ju ose personi i afërm me ju ka interes privat për një vendimmarrje të caktuar

- Bëni deklarin rast pas rasti të interesave (neni 17 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit);
- Tërhiquni nga vendimmarrja.

Deklarimi rast pas rasti bëhet:

- ✓ sa më shpejt të jetë e mundur,
- ✓ para një vendimmarrjeje,
- ✓ me shkrim, ose duke përdorur një formular të caktuar.

Ju mund të bëni gjithashtu deklaram rast pas rasti kur kërkohet nga eprori ose institucioni udhëheqës ose mbikëqyrës. Kur kërkohet, deklarata duhet të dorëzohet gjithsesi, edhe nëse asnjë interes privat nuk mund të shkaktojë konflikt interesi në një rrethanë të caktuar.

Deklarimi rast pas rasti i konfliktit të interesit përbën një akt formal për t'i informuar të tjerët dhe për të raportuar tek eprori në lidhje me praninë e një interesi privat që mund të ndikojë në kryerjen e detyrave zyrtare në një proces vendimmarrës për një çështje të caktuar ku përfshihet zyrtari.

Deklarimi rast pas rasti i interesave është i detyrueshëm për çdo zyrtar. Shpesh ai përdoret në rrethana që lidhen me rekrutimin ose komisione të vlerësimit të prokurimit, inspektime ose auditime, hetime, diskutime ose votime në organe kolegjiale dhe vendimmarrje për vendime, procese ose veprimtari zyrtare të veçanta.

Paraqitja e deklaratës rast pas rasti është veçse hapi i parë në zgjidhjen e konfliktit të interesit. Është përgjegjësia juaj dhe e eprorit tuaj që ta zgjidhni konfliktin e interesit në mënyrë efektive. Ligji parasheh masa që një zyrtar dhe eprori i tij/saj ose institucioni udhëheqës mund të marrin në varësi të rastit dhe të rrethanave. Për më tepër, mund të merren edhe masa të tjera sipas nevojës.

Masat e mundshme  
nga një zyrtar

- *Transferimi* i interesit privat dhe i të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes;
- *Vetëpërfshajtimi* nga vendimmarrja, diskutimi ose votimi;
- *Dorëheqja* nga veprimtaritë që janë në konflikt ose të papajtueshme me funksionin tuaj publik;
- *Dorëheqja* nga funksioni juaj publik.

Masat që merren  
nga eprori ose  
institucioni udhëheqës

- *Kufizohet* informacioni për zyrtarin;
- *Shmanget caktimi* i detyrave apo i përgjegjësive specifike për zyrtarin;
- Zyrtari *përfshahet* nga vendimmarrja;
- Detyrat dhe kompetencat e zyrtarit *rishikohen ose ndryshohen*;
- Zyrtari *transferohet* në pozitë tjetër;
- *Shmanget emërimi apo zgjedhja* e zyrtarit në një funksion të caktuar;
- Akti i kryer në konflikt interesi *revokohet ose anulohet*.

## 5.2. Zgjidhja e konfliktit të interesit pas marrjes së detyrës së re


(neni 8 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit)

Nëse dyshoni ose përcaktoni se konflikti i interesit ka ndodhur ose mund të ndodhë

- *Pezulloni* të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me çështjen;
- *Konsultohuni* dhe njoftoni eprorin tuaj ose organin udhëheqës / mbikëqyrës sa më parë të jetë e mundur;
- Nëse jeni zyrtar drejtues dhe nuk keni epror të drejtpërdrejtë, *çështjen ia përcillni* institucionit udhëheqës / mbikëqyrës dhe këshillohuni me Agjencinë kundër Korrupsionit.

Ashtu si në rastin e zgjidhjes rast për rast të konfliktit të interesit, pezullimi i veprimeve dhe njoftimi i eprorit janë vetëm hapat e parë në zgjidhjen e konfliktit të interesit. Brenda 30 ditësh, zyrtari ose institucioni duhet të ndërmarrin hapat e nevojshëm që paraqiten në grafikun më poshtë.

## Parandalimi dhe zgjidhja e konfliktit të interesit



## 6. PËRGJEGJËSITË E DREJTUESVE DHE INSTITUCIONEVE PUNËDHËNËSE

Sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konflikti i interesit duhet fillimisht dhe përgjithësisht të zgjidhet brenda institucionit. Agjencia kundër Korrupsionit përfshihet në rrethana specifike vetëm kur zgjidhja është e pamundur edhe pasi ndërmerren të gjithë hapat e nevojshëm brenda institucionit ose institucionit udhëheqës.

### 6.1 Përgjegjësitë e drejtuesit

Nëse jeni drejtues, keni përgjegjësi specifike lidhur me konfliktin e interesit:

- ✓ **Kërkoni deklaram rast pas rasti të interesave private** të një vartësi, qoftë i konsultuar ose i informuar nga zyrtari në fjalë ose sipas detyrës zyrtare (neni 8, paragrafi 2; neni 17, paragrafët 2 dhe 3 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit);
- ✓ **Parandaloni ose zgjidhni një konflikt interesi** kur keni dijeni në lidhje me konfliktin real ose të mundshëm të interesit të një vartësi;
- ✓ **Drejtojuni Agjencisë kundër Korrupsionit**, nëse nuk jeni të sigurt si ta zgjidhni konfliktin e interesit të një vartësi, ose e perceptoni se mund të jeni në konflikt interesi në atë rast (neni 8, paragrafët 4 dhe 5);
- ✓ **Njoftoni Agjencinë** për masat që janë marrë për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit ose papajtueshmërive (neni 19, paragrafi 4);
- ✓ **Paraqitni kallëzim penal** në prokurori ndaj zyrtarit që ka kryer veprë penale (neni 24, paragrafi 3).

Ju mbani përgjegjësi qoftë si zyrtar apo epror i tij/saj kur masat e ndërmarra rezultojnë joefektive në parandalimin apo zgjidhjen e konfliktit të interesit apo papajtueshmërive.

### 6.2 Detyrat kryesore të institucionit

Nëse jeni drejtues i një institucioni, mbani parasysh detyrat kryesore të institucionit:

- ✓ **Përcaktoni rregullat e konfliktit të interesit** në rregulloret e brendshme me ndihmën e Agjencisë kundër Korrupsionit, sipas nevojës dhe siguron zbatimin e tyre (neni 20, paragrafi 3);
- ✓ **Regjistroni rastet e konfliktit të interesit** që kanë ndodhur në institucion dhe hollësitë e rezultatet e secilit rast (neni 17, paragrafi 4, neni 20, paragrafi 5);
- ✓ **Mblidhni dhe verifikoni informacionin** për interesat private të zyrtarëve (neni 20, paragrafi 4, nënparagrafët 4.1 dhe 4.2);
- ✓ **Parandaloni dhe zgjidhni konfliktin e interesit** në mënyrë proporcionale dhe **informoni Agjencinë kundër Korrupsionit** rreth masave të ndërmarra në lidhje me konfliktin e interesit ose papajtueshmëritë (neni 19, paragrafët 2 dhe 4);
- ✓ **Kufizoni bashkëpunimin e biznesit me ish-zyrtarë të lartë** të institucionit në rrethanat e përcaktuara me ligj (neni 18, paragrafi 2);
- ✓ **Njoftoni Agjencinë kundër Korrupsionit për shkeljet** e kufizimeve pas punësimit që zbatohen për ish-zyrtarët e lartë të institucionit (neni 18, paragrafi 3);
- ✓ **Vini në dispozicion dhe/ose jepni qasje** te informacionet dhe burimet e nevojshme në dobi të Agjencisë kundër Korrupsionit jo më vonë se 15 ditë për verifikim dhe hetim të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërive (neni 21, paragrafi 4);



- ✓ **Nisni procedurën për shkarkimin e zyrtarit** në rrethanën e papajtueshmërisë, me kërkesë të Agjencisë dhe njoftoni Agjencinë për veprimet e ndërmarra brenda 15 ditëve (neni 22, paragrafët 9 dhe 11);
- ✓ **Nisni procedurën për kundërvajtje** (neni 23, paragrafi 3);
- ✓ **Nisni procedurën disiplinore** (neni 24, paragrafi 1);
- ✓ **Ushtroni kallëzim penal** në prokurori ndaj zyrtarit që ka kryer vepër penale (neni 24, paragrafi 3);
- ✓ **Filloni ose ndiqni veprime ligjore** në lidhje me rishikimin, revokimin dhe/ose anulimin e akteve ose kontratave të nxjerra/të lidhura në konflikt interesi si dhe veprimin e duhur në lidhje me vlerësimin e dëmit dhe zgjidhjen e pasojave (neni 22, paragrafët 13 dhe 14);
- ✓ **Dorëzoni raportin vjetor** pranë Agjencisë me informacion se si institucioni ka administruar konfliktin e interesit (neni 20, paragrafi 6).

Rregullat për konfliktin e interesit në rregulloret e brendshme mund të përcaktojnë çështje të ndryshme si:

- ✓ Udhëzime të hollësishme se si të shmangen konflikti në dukje dhe konflikti i mundshëm i interesit, që mund të ndodhin shpesh brenda institucionit;
- ✓ Procedura për administrimin e konfliktit në dukje apo konfliktit të mundshëm të interesit;
- ✓ Krite specifike për punët e jashtme të kufizuara ose të ndaluara për zyrtarët;
- ✓ Formularë dhe procedura për regjistrimin e brendshëm sistematik të interesave private të zyrtarëve (shih Shtojcën 3).

Vini re se Agjencia kundër Korrupsionit ofron këshilla për zyrtarët dhe drejtuesit, si dhe nxjerr opinione se si të zgjidhen rastet e konfliktit të interesit, në vend që të veprojnë vetë në këto raste.

Megjithatë, Agjencia është e autorizuar që në rolin e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, të ndërmarrë masa ligjore dhe veprime juridike në institucionin kompetent në përputhje me ligjin, përfshirë procedura juridike kundër akteve dhe kontratave të nxjerra / të lidhura në rrethana të konfliktit të interesit.

## 7. VEPRIMTARITË E JASHTME

### 7.1 Rregullat e përgjithshme

Zyrtarëve u lejohej të punojnë në punë të tjera krahas pozitave të tyre publike. Pjesëmarrja në veprimtari të jashtme duhet të ndodhë jashtë orarit të zakonshëm të punës. Mirëpo, ekzistojnë kufizime dhe kushte për veprimtari të jashtme të cilat janë të papajtueshme me kryerjen e detyrave publike.

Të lejuara (nëse ligji nuk e përcakton ndryshe)	Të ndaluara
<ul style="list-style-type: none"><li>• Funksione në një parti politike (për zyrtarë të zgjedhur si përfaqësues të një partie).</li><li>• Veprimtari në fushat e shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtari humanitare.</li><li>• Përftimi i bazuar në të drejtën e autorit, patentat, pronësinë intelektuale dhe industriale dhe të drejta të ngjashme me to.</li></ul>	<ul style="list-style-type: none"><li>• Punë tjetër kur ka mundësi të keqpërdoret informacioni zyrtar.</li><li>• Punë tjetër që cenon paanshmërinë në kryerjen e detyrës publike dhe cenon pajtueshmërinë me parimet e konkurrencës.</li><li>• Angazhime që mund të dëmtojnë emrin e institucionit.</li><li>• Angazhime që ndërlidhen me përzgjedhjen, emërimin ose caktimin në institucione vartëse (përveç nëse parashikohet me ligj).</li><li>• Angazhime të ndërlidhura me fitime nga personat juridikë privatë që përfitojnë kontrata publike, grante ose fonde të tjera publike, privatizim të pronës publike, lehtësi nga detyrimet doganore ose tatimore ose që ushtrojnë veprimtari në zona të lira, në rastet kur zyrtari është përfshirë gjatë ushtrimit të funksionit dhe ka ndikuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në fitimin e këtyre të drejtave në dobi të tyre.</li></ul>

- ✓ Keqpërdorimi i informacionit zyrtar do të ndodhte, për shembull, nëse zyrtari i ka siguruar informacion të privilegjuar punëdhënësit të vet privat.
- ✓ Puna e jashtme nuk duhet të çojë drejt konfliktit të interesit. Nëse paraqitet konflikti i interesit, ai duhet të administrohet në përputhje me ligjin dhe rregulloret e brendshme. Për shembull, një zyrtar nuk duhet të marrë pjesë në dhënien e kontratës një organizate joqeveritare ku punon vetë ose një familjar i tij/saj. Nëse ky zyrtar nuk merr pjesë në dhënien e kontratës, por ka mundësinë që të ndikojë në të, rrethana trajtohet si konflikt në dukje i interesit.
- ✓ Parimet e konkurrencës cenohen, për shembull, nëse zyrtari i prokurimit i ka siguruar informacion të privilegjuar punëdhënësit të tij/saj privat dhe kështu i ka dhënë operatorit ekonomik përparësi konkurruese.
- ✓ Institucionet publike duhet të specifikojnë kufizimet në rregulloret e tyre të brendshme, për shembull, të përkufizojnë llojet e punëve të tjera që dëmtojnë emrin e institucionit. Në varësi të gjykimit të institucionit, këto punë mund të kenë lidhje me ushtrimin e një veprimtarie me pije alkoolike, punën për një subjekt të përfshirë në veprimtari të paligjshme, ofrimin me pagesë të shërbimeve që janë të ngjashme me ato që ofron institucioni, etj.

Institucionet mund të caktojnë edhe rregulla shtesë lidhur me punët e jashtme, për shembull, të ndalojnë përfshirjen në veprimtari të jashtme gjatë orarit të zakonshëm të punës, të caktojnë kufi të pagës në punën tjetër në krahasim me pagën e zyrtarit, apo të kërkojnë që eprorit të drejtpërdrejtë t'i jepin informacione të hollësishme për veprimtarinë e jashtme. Në disa institucione, zotimi në punë të jashtme lejohet vetëm me autorizimin përkatës të drejtuesit.

Sa herë që shqyrtoni mundësinë e zotimit në punë shtesë, duhet të konsultoheni jo vetëm me ligjin, por edhe me rregulloret që ka miratuar institucioni juaj.

Për më tepër, sipas Kodit të Mirësjelljes së Shërbyesit Civil në Kosovë, shërbyesi civil:

- ✓ nuk duhet të përfshihet në veprimtari të jashtme që pengojnë kryerjen e detyrave zyrtare dhe që cenojnë në çfarëdo mënyre realizimin e objektivave të institucionit;
- ✓ duhet të njoftojnë paraprakisht udhëheqësin drejtues dhe njësinë e personelit lidhur me zotimet e jashtme;
- ✓ mund të përfshihen në veprimtari sindikale ose të përfaqësimit të shërbyesve civilë, ose në veprimtari mësimdhënëse, hulumtuese dhe trajnuese, kur ato nuk pengojnë kryerjen e detyrës dhe nuk bien ndesh me natyrën e punës.

Ka edhe papajtueshmëri të tjera, për shembull ndërmjet emërimeve politike dhe statusit të shërbyesit civil (neni 17, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil).

## 7.2 Rregulla shtesë për zyrtarët e lartë

Të lejuara	Të ndaluara
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Anëtarësi pa pagesë në një organ drejtues (me përjashtim të funksionit drejtues) të një organizate joqeveritare në fushën e shkencës, sportit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme;</li> <li>• Pozita në parti politike;</li> <li>• Anëtarësi pa pagesë në një organ drejtues të ndonjë ndërmarrjeje publike apo shoqërie aksionare apo në një organ të ndonjë institucioni tjetër publik (përveç nëse ligji lejon shprehimisht më shumë poste).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Veprimtari profesionale të avokatisë, noterisë, përmbaruesit privat, ekspertit të licencuar, konsulentit ose agjentit të personave juridikë, nëse këto veprimtari kërkojnë licencim;</li> <li>• Punë tjetër me orar të plotë;</li> <li>• Të qenit menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi drejtues ose mbikëqyrës të personave juridikë privatë fitimprurës dhe organizatave joqeveritare me përjashtim të rasteve kur kjo pozitë diktohet për shkak të funksionit të tyre publik.</li> </ul>

### 7.3 Shembuj të veprimtarive të jashtme

#### 7.3.1 Situata 1

Funksioni i zyrtarit të lartë përfshin vlerësimin e kërkesave për financim që paraqiten nga universitetet shtetërore. A mund të punojë zyrtari si profesor në ndonjërin nga këto universitete shtetërore?

Përgjithësisht, zyrtarëve u lejohet të zotohen në veprimtari të jashtme në sferën e arsimit. Prandaj, zyrtari mund të punojë si profesor nëse respekton rregullat e zbatueshme për punët e jashtme.

Sidoqoftë, me këtë punësim të jashtëm, universiteti bëhet subjekt juridik i afërm me zyrtarin. Interesat e universitetit mund të ndikojnë te kryerja e detyrave të zyrtarit, në rastin e vlerësimit të kërkesave për fonde nga ky universitet ose universitete të tjera, kur ka garë për fonde të pakta. Prandaj, kjo rrethanë çon drejt konfliktit të mundshëm të interesit. Konfliktet e interesit që ndodhin mund të zgjidhen rast për rast, por rekomandohet rishikimi i përhershëm i detyrave (ndërprerja e përfshirjes në vlerësimin e kërkesave për fonde), nëse zyrtari dëshiron të ruajë pozitën e profesorit.

Është me rëndësi që zyrtari i lartë të sigurohet se nuk ka pozitë drejtuese me pagesë (rektor, dekan, etj.) në universitet, pasi pozita të tilla të jashtme nuk lejohen për zyrtarët e lartë në institucionet publike.

#### 7.3.2 Situata 2

A mundet një zyrtar me funksion auditor në administratën tatimore të punojë si kontabilist?

Ky kombinim i veprimtarive nuk është i lejueshëm. Meqë kontabilisti është përgjegjës për të siguruar respektimin e legjislacionit tatimor, auditori i administratës tatimore mund të keqpërdorë informacionin zyrtar dhe ta ndihmojë subjektin të shmangë kontrollin e administratës tatimore. Kjo veprimtari shtesë mund të cenojë parimet e konkurrencës, pasi i siguron përparësi të padrejtë subjektit dhe dëmton emrin e administratës tatimore, duke krijuar përshtypjen se zyrtarët tatimorë ndihmojnë privatisht disa operatorë ekonomikë.

E njëjta qasje vlen edhe për situatat kur detyrat e zyrtarit përfshijnë kontrollin ose inspektimin, ndërkohë që veprimtaria e pritshme private përfshin sigurimin e pajtueshmërisë së subjektit privat në të njëjtën sferë. Shih edhe pyetjen pasardhëse.

#### 7.3.3 Situata 3

A mundet një zyrtar të punojë si komisioner i doganave nëse vendi ku shërben është dogana?

Ky kombinim i veprimtarive nuk është i lejueshëm. Meqë komisioneri i doganave është përgjegjës për respektimin e rregullave në dogana, zyrtari mund të keqpërdorë informacionin zyrtar dhe të ndihmojë subjektin të anashkalojë kontrollin e doganor. Kjo veprimtari shtesë gjithashtu mund të cenojë parimet e konkurrencës, duke i dhënë përparësi të padrejtë subjektit dhe të dëmtojë emrin e doganës, duke krijuar përshtypjen se zyrtarët e doganave ndihmojnë privatisht disa operatorëve ekonomikë.

### 7.3.4 Situata 4

A mundet një shërbyes civil i Ministrisë së Bujqësisë të praktikojë punën si këshilltar për fermerët pas orarit të punës?

Nga këndvështrimi i legjislacionit për konfliktin e interesit, kjo praktikë lejohet në varësi të disa rrethanave. Ashtu si në situatat 2 dhe 3 më lart, shërbyesi civil që punon në një njësi me funksione kontrolli dhe inspektimi, nuk duhet të punojë për një punëdhënës privat për të siguruar respektimin e rregullave të zbatueshme.

Për më tepër, puna private nuk duhet të ketë përplasje apo mbivendosje me funksionin publik, apo të jetë vazhdim ose zgjatje e këtij të fundit. Për shembull, nëse ofrimi i këshillave për fermerët është pjesë e detyrave zyrtare, këshillimi privatisht i tyre kundrejt pagesës mund të krijojë përshtypjen se ai, në cilësinë e shërbyesit civil, jep qëllimisht këshilla të cunguara për të nxitur kërkesën për këshillime private. Kjo rrethanë mund të cenojë paanshmërinë e kryerjes së detyrës publike (cilësia e këshillës zyrtare) dhe ka rrezik të dëmtojë emrin e institucionit (duke krijuar përshtypjen se shërbyesi civil pret pagesë në formën e shpërblimit në para për shërbimin privat). Situata e krijuar përbën së paku konflikt në dukje të interesit.

### 7.3.5 Situata 5

A mundet një zyrtar të punojë njëkohësisht si ekspert gjyqësor?

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në përgjithësi, nuk e ndalon zyrtarin të veprojë si ekspert gjyqësor. Megjithatë, duhet të merren parasysh funksionet e institucionit publik, përgjegjësitë e zyrtarit dhe fusha e ekspertizës. Zyrtari nuk duhet të jetë ekspert gjyqësor në ndonjë çështje ku është i përfshirë institucioni ku ushtron detyrën publike, pasi kjo do të komprometonte paanshmërinë e ekspertizës dhe emrin e institucionit, çka mund të perceptohet si përpjekje për të ndikuar në çështjen gjyqësore në favorin e vet duke komprometuar ekspertizën gjyqësore.

Zyrtari i lartë e ka të ndaluar të punojë si ekspert, nëse për këtë qëllim kërkohet licencë.

### 7.3.6 Situata 6

A mundet një zyrtar të punojë si rojë sigurie private gjatë kohës kur është i lirë nga shërbimi publik?

Po, me kushtin që ofrimi i mbrojtjes të mos jetë pjesë e detyrave zyrtare. Përndryshe, krijohet përshtypja se institucioni publik u jep mbrojtje përparësore punëdhënësve private të zyrtarit. Kjo mund të dëmtojë emrin e institucionit. Gjithashtu, ekziston rreziku që simbolet (stemat etj.) dhe pajisjet e institucionit të përdoren gjatë ofrimit të shërbimit privat.

### 7.3.7 Situata 7

A mundet një zyrtar i lartë të bëhet anëtar i bordit të ndonjë OJQ-je për luftën kundër korrupsionit, nëse nuk paguhet për anëtarësi?

Po, kjo anëtarësi lejohet. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar pa pagesë në organin drejtues të ndonjë organizate joqeveritare në fushën e shkencës, sportit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme (neni 14, paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit). Për orientime lidhur me veprimtari të ngjashme, mund të shihni nenin 17 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, që përcakton veprimtaritë e OJQ-ve që janë të pranueshme për statusin e përfutuesit publik. Këto veprimtari përfshijnë promovimin e të drejtave të njeriut, praktikat demokratike dhe shoqërinë civile. Duke interpretuar ligjin në mënyrë sistematike, mund të arrihet në përfundimin se veprimtaritë kundër korrupsionit u përkasin veprimtarive me interes publik dhe janë të ngjashme me veprimtaritë e përkufizuara në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

### **7.3.8 Situata 8**

A mundet një zyrtar të punojë si konsulent i një shoqërie ku drejtorët ekzekutivë janë nën hetim për rryshfet?

Zyrtari nuk mund të përfshihet në punë shtesë që mund të dëmtojnë emrin e institucionit. Të punosh për një punëdhënës që njihet apo dyshohet si i përfshirë në veprimtari të paligjshme aktualisht ose rishtazi, mund të dëmtojë emrin e institucionit. Kjo situatë mund të krijojë përshtypjen se institucioni toleron paligjshmërinë, apo që zyrtarët e tij madje marrin pjesë vetë në veprime të paligjshme. Para se të ndërmerren punë shtesë, zyrtari duhet t'i kushtojë vëmendje informacionit për punëdhënësin e mundshëm dhe, kur është e nevojshme, t'i kërkojë punëdhënësit të shpjegojë veprimtarinë. Me fjalë të tjera, zyrtari duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për t'u bindur se punëdhënësi nuk përbën rrezik për dëmtim të emrit.

### **7.3.9 Situata 9**

A mundet një person të marrë pozitën e drejtorit të një teatri shtetëror gjatë kohës që është shërbyes civil në Ministrinë e Kulturës?

Jo, emërimi i tillë shkel ndalimin e përfshirjes në punë të tjera që kanë të bëjnë me përzgjedhjen, emërimin ose caktimin në institucione të varura të institucionit punëdhënës, me përjashtim të rasteve sipas ligjit specifik. Në varësi të rregullave të tjera të zbatueshme, lejohet përfshirja artistike (jo e natyrës menaxhuese) në teatër.

### **7.3.10 Situata 10**

A mundet anëtarët e kuvendit komunal në të njëjtën kohë të mbajnë pozita si ndihmës të kryetarit të komunës, shefit të njësisë së administratës komunale, drejtorit të ndërmarrjes komunale apo ndonjë subjekti tjetër, zëvendësdrejtorit të shkollës, etj.? A mundet kryetari i kuvendit të punojë si mësimdhënës në shkollë komunale brenda të njëjtës komunë?

Në përgjithësi, anëtarëve të kuvendit komunal u lejohet të përfshihen në punë të tjera. Sidoqoftë, Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (neni 65.2) në mënyrë të qartë ua ndalon drejtorëve komunalë, drejtorëve të institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe shërbyesve civilë të administratës së komunës që të jenë anëtarë të kuvendit komunal përkatës. Prandaj, për sa kohë që pozitat e përmendura në rrethanat e mësipërme i korrespondojnë ndonjëres prej kategorive të përmendura në nenin 65.2 të këtij Ligji, kombinimi i pozitave nuk lejohet.

Për më tepër, kuvendet komunale kanë fuqi të marrin vendime lidhur me menaxherët e subjekteve vartëse në komunë. Për të shmangur mundësinë e konfliktit të interesit, anëtari i kuvendit duhet të mos ketë pozitë mbi të cilën kuvendi ka fuqi të drejtpërdrejtë vendimmarrëse edhe nëse kjo punë shtesë nuk ndalohet në mënyrë të qartë. Lidhur me pozitat mbi të cilat pushteti i kuvendi ka fuqi disi të tërthortë (pozita që mund të preken përmes miratimit të rregulloreve ose alokimit të fondeve), komuna mund të specifikojë rregulla brenda kufijve të përcaktuar me ligj.

Kryesuesit e kuvendeve komunale janë zyrtarë të lartë. Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ua pengon një punë tjetër me orar të plotë. Prandaj, kryesuesi i kuvendit mund të punojë si mësimdhënës në shkollë komunale vetëm me orar të pjesshëm dhe për aq sa kompetencat e veta brenda kuvendit nuk cenojnë postin e mësimdhënësit në mënyrë që të shkaktojë konflikt interesi.

## 8. DHURATAT

Nëse dikush i ofron një dhuratë zyrtarit publik, krijohet një lidhje personale mes dy individëve, e cila mund të shtrembërojë përmbushjen e detyrave dhe të krijojë konflikt interesi. Prandaj, ligji parashikon rregulla të prera në lidhje me dhuratat.

Tabela e mëposhtme përmbledh rregullat e përcaktuara në Ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë dhe në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

A mund të pranoni një dhuratë si zyrtar publik?<sup>7</sup>

PO

- Dhurata të protokollit.
- Dhurata të rastit - në vlerë jo më të lartë se 25 euro.

JO

- Dhurata të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen e detyrave zyrtare.
- Kompensim për pozicionin tuaj në vendimmarrje.
- Dhurata të rastit me vlerë të përgjithshme brenda vitit më të larta se 500 euro.
- Më shumë se një dhuratë të rastit në vit nga i njëjti person.
- Mjete financiare, letra me vlerë, metale të çmuara të çfarëdo vlere.
- Dhurata nga shoqëri publike dhe nga furnizues ose klientë të këtyre shoqërive (shih kushtet në ligj).
- Dhurata nga persona juridikë privatë të cilët kanë fituar kontrata publike, fonde, etj. ... nëse keni qenë të përfshirë dhe keni ndikuar në dhënien e të drejtës (shih kushtet në ligj).

Si zyrtar publik, mos kërkoni kurrë dhuratë!

Sigurohuni që të deklaroni të gjitha dhuratat pranë institucionit tuaj për regjistrim. Informoni eprorin tuaj me shkrim, nëse ju është ofruar apo ju është dhënë ndonjë dhuratë. Informoni Agjencinë kundër Korrupsionit nëse jeni udhëheqës i institucionit.

Të gjitha dhuratat bëhen pronë e institucionit ku ushtroni detyrën, përveç dhuratave të rastit me natyrë personale.

Në lidhje me dhuratën e rastit, mund t'ju duket e vështirë të vendosni vlerën e saktë. Nëse dyshoni se vlera mund të jetë më e lartë se 25 euro, refuzojeni dhuratën me mirësjellje. Më mirë të jeni të sigurt!

Mund të keni edhe dyshime se mos të tjerët kujtojnë se dhurata mund të ndikojë në ushtrimin e detyrës suaj. Vendosni nëse ta pranoni apo jo një dhuratë të tillë, duke menduar në përputhje me listën e kontrollit më poshtë.

<sup>7</sup> Ka mospërputhje dhe dispozita kontradiktore në Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil (neni 33) dhe Ligjin nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë (neni 11) që vendos kufijtë më të ulët dhe më të lartë për dhuratat e lejuara, përkatësisht 50 euro deri në 100 euro në të parin dhe 25 euro deri në 500 euro në të fundit. Duke qenë se Ligji nr. 04/L-050 përmban dispozita të mëvonshme dhe se fusha e tij mbulon të gjithë zyrtarët publikë, përmendja është bërë te dispozitat e tij.



## 8.1 Lista e kontrollit për dhuratat dhe bakshishet<sup>8</sup>

G	<i>Genuine</i> "E mirëfilltë"	A është kjo dhuratë e mirëfilltë në këmbim të përpjekjes sime dhe jo kompensim për një vendim, që nuk është kërkuar apo nxitur nga unë?
I	<i>Independent</i> "I/e pavarur"	Nëse e pranoj këtë dhuratë, a do të dyshonte një person i arsyeshëm në kryerjen me pavarësi të detyrave të mia në të ardhmen? Duhet pasur kujdes i veçantë në rastet kur dhuruesi është i përfshirë ose preket nga një vendim që e kam unë në dorë.
F	<i>Free</i> "I/e liruar"	Nëse e pranoj këtë dhuratë, a ndihem i lirë dhe i padetyruar për të bërë diçka në këmbim në favor të dhuruesit apo të familjes ose miqve/bashkëpunëtorëve të tij/saj?
T	<i>Transparent</i> "Transparent"	A jam i/e gatshme të deklaroj këtë dhuratë dhe burimin e saj në mënyrë transparente, te organizata ime dhe te klientët e saj, kolegët e punës, në media dhe te publiku në përgjithësi?

## 9. VEPRIMET KUNDËR NDIKIMIT NË VULLNETIN E ZYRTARIT

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ju detyron që të ndërmerri hapa nëse dikush përpiqet të ndikojë apo ushtron ndikim në vullnetin tuaj.

Shembull i një përpjekjeje për të ndikuar në vullnetin tuaj


- Jeni anëtar i një komisioni të vlerësimit të ofertave në procedurë prokurimi. Një biznesmen ju takon dhe ju thotë se do të kishit mundësi të shkëlqyera për të bërë karrierë, nëse mbështetni një furnizues të caktuar.

Shembull i ndikimit të ushtruar në vullnetin tuaj

- Jeni anëtar i një komisioni të vlerësimit të ofertave në procedurë prokurimi. Drejtori i institucionit tuaj ju thotë të mbështetni një furnizues të caktuar pa bazë ligjore, ndryshe do të transferoheni në pozitë më të ulët.

<sup>8</sup> Kjo tabelë është përshtatur nga: "OECD (2005), "Udhëzues: Menaxhimi i Konfliktit të Interesit në Sektorin Publik" për ta përfuar me legjislacionin e Kosovës. Botim nga OECD, gjendet në [www.oecd.org](http://www.oecd.org)

## Veprimet kundër ndikimit mbi vullnetin tuaj



## **10. DETYRIMET DHE SANKSIONET E TJERA**

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit përmban disa ndalime, detyrime dhe kufizime të tjera.


### **10.1. Veprimet e ndaluara**

Veprimet e ndaluara për zyrtarët renditen në nenin 9 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe përfshijnë ndalime që kanë të bëjnë me dhurata dhe përfitime të parregullta si dhe disa veprime të tjera.

### **10.2. Transferimi i të drejtave të administrimit apo drejtimit të ndërmarrjes**

Transferimi i të drejtave të administrimit apo drejtimit të ndërmarrjes tek një administrator i besuar është një nga detyrimet për zyrtarët e lartë që kanë në pronësi aksione ose pjesë të kapitalit në një ndërmarrje, gjatë ushtrimit të funksionit publik (neni 15 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

## Transferimi i të drejtave të administrimit apo drejtimit



Ndërmarrjet që administrohen nga personi i besuar ose i afërm i zyrtarit të lartë nuk kanë të drejtë të lidhin kontrata me/të përfitojnë ndihmë nga institucioni qendror ose lokal i zyrtarit të lartë.

Personi i besuar duhet të jetë në gjendje të ushtrojë të drejtat në mënyrë të pavarur. Në mënyrë specifike, person i besuar nuk mund të jetë bashkëshorti/ja, fëmijët, ndonjë zyrtar apo person tjetër me lidhje varësie qoftë edhe të tërthortë, për shkak të funksionit publik me zyrtarin në fjalë dhe një ndërmarrje apo organizatë jofitimprurëse ku zyrtari zotëron pjesë në kapital ose aksione, apo ku ka pasur ose ka marrëdhënie interesi të çfarëdo lloji (neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Marrëveshjet e arritura para hyrjes në fuqi të ligjit aktual duhet të ndërpriten në rast se nuk janë në pajtim me këto kufizime. Në raste të tilla, duhen lidhur marrëveshje të reja besimi.

### 10.3. Kufizimet pas punësimit

Kufizimet ndaj zyrtarëve të lartë vlejnë edhe për dy vjet pas përfundimit të funksionit publik (neni 18).

#### PËR DY VJET NGA PËRFUNDIMI I FUNKSIONIT PUBLIK, ZYRTARI I LARTË NUK KA TË DREJTË:

- Të marrë pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e një subjekti;
- që ka marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka punuar zyrtari,
- nëse detyrat e zyrtarit gjatë periudhës dyvjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejt të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo ndëshkimin e subjektit;
- Të përfshihet në marrëdhënie kontraktore me institucionin ku zyrtari ka ushtruar funksionin publik;
- Të përfaqësojë, ndihmojë ose këshillojë personat në konflikte ose marrëdhënie biznesi me institucionin lidhur me punën që ai/ajo ka kryer (ose kryen);
- Të përdorë informacion të privilegjuar ose konfidencial të siguruar gjatë ushtrimit të funksionit publik për interesa të veta private ose për interesa të një personi të afërm apo të besuar.

Shembull i  
kufizimeve pas  
punësimit

- Ju keni lënë një pozitë në bordin e një ndërmarrje publike. Si anëtar i bordit, keni mbikëqyrur punime të ndërtimit të kryera nga një shoqëri private për ndërmarrjen publike. Në rast se shoqëria private ju ofron një pozitë menaxhuese, ju duhet ta refuzoni atë, deri sa të kalojnë dy vjet nga data kur jeni larguar nga bordi.

**Për një vit pas përfundimit të funksionit publik**, institucioni ku zyrtari i lartë ka ushtruar funksionin publik nuk mund të ketë marrëdhënie biznesi me subjektin ku ish-zyrtari, ndonjë person i afërm me të apo person i besuar kanë pjesë në kapital prej jo më pak se 5%.

### 10.4 Sanksionet

- ✓ Veprimi në gjendje të konfliktit të pazgjidhur të interesit mund të jetë vepër penale (neni 417 i Kodit Penal);
- ✓ Shkelje të tjera të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit janë kundërvajtje të dënueshme me gjobë (neni 23, paragrafi 1);
- ✓ Çfarëdo shkelje e Ligjit konsiderohet dhe si shkelje disiplinore (neni 24, paragrafi 1);
- ✓ Nëse jeni zyrtar i lartë, drejtues apo udhëheqës i ndonjë institucioni menaxhues, gjykata mund të shqiptojë ndalim të ushtrimit të funksionit publik (neni 23, paragrafi 2).

## 11. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME PËR PËRDORIMIN E UDHËZUESIT

Miratimi i Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik në vitin 2018 ishte hap madhor drejt zhvillimit të mëtejshëm të sistemit të integritetit në Kosovë. Ligji ka fuqizuar kornizën e konfliktit të interesit për zyrtarët e rangut më të ulët dhe të mesëm, ka përfshirë procedura të hollësishme për zgjidhjen e konflikteve të interesit dhe ka sjellë disa përmirësime kyçe. Konsultimet e bëra me palët e interesit para përgatitjes së këtij udhëzuesi dëshmojnë se tashmë ka njohuri mjaft të mira rreth administrimit të konfliktit të interesit në radhët e zyrtarëve të Kosovës.

Administrimi i efektshëm i konfliktit të interesit kërkon shpërndarjen e aftësive përkatëse në të gjithë sektorin publik. Për më tepër, kjo është një sferë ku zyrtarët shpesh përballen me lloje të reja rrethanash që nuk ngjasojnë me përvojat e kaluara. Prandaj, ofrimi i udhëzimeve dhe këshillimeve është proces i vazhdueshëm ku ky udhëzues shërben si ndihmesë.

1. Ky udhëzues përmban udhëzime që ndihmojnë në respektimin e ligjit. Shfrytëzimi i udhëzuesit nuk çliron zyrtarët nga përgjegjësia e respektimit të rreptë të dispozitave ligjore. Kur duhet të vendosni si të veproni, duhet gjithnjë të konsultoheni me ligjin.
2. Sa herë jeni në dyshim për mundësinë e konfliktit të interesit, konsultohuni me zyrtarin epror ose me organin udhëheqës/mbikëqyrës.
3. Nëse jeni zyrtar i lartë i veçantë ose drejtues, në raste specifike të konfliktit të interesit dhe lidhur me nisma për parandalimin e konfliktit të interesit, mund t'i drejtoheni për këshillim edhe Agjencisë kundër Korrupsionit (edhe pasi keni shtuar të gjitha mjetet e brendshme në institucionin tuaj).
4. Drejtuesit duhet të inkurajojnë diskutimet e brendshme të personelit për konfliktin e interesit dhe çështje të tjera të integritetit, në mënyrë që të përhapin njohuritë ndër punonjësit, të zvogëlojnë pasiguritë dhe të forcojnë zotimin për ruajtjen e standardeve të larta.
5. Duke ofruar lehtësisht qasje në këshillim të brendshëm, institucionet duhet të krijojnë mjedis pune që mbështet zyrtarët të cilët në mirëbesim kërkojnë përgjigje lidhur me zbatimin e saktë të rregullave të konfliktit të interesit.
6. Institucionet duhet të miratojnë rregullore të brendshme për administrimin e konfliktit të interesit. Rregullat duhet të specifikojnë se si trajtohen llojet e përsëritura dhe sfiduese të konfliktit real, në dukje dhe të mundshëm të interesit. Institucioni duhet të kërkojë nga të gjithë aplikuesit për vende pune, që t'ua bëjnë me dije zyrtarëve përgjegjës nëse kanë të afërm që punojnë në institucion.
7. Institucioni duhet të sigurohet se ka informacion të plotë dhe të përditësuar për veprimtaritë e jashtme të zyrtarëve të vet.
8. Autoritetet të cilat janë përgjegjëse për zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit duhet të kërkojnë mundësi për të siguruar trajnime të rregullta në klasa dhe në internet, lidhur me administrimin e konfliktit të interesit. Autoritetet mund t'ua rikujtojnë zyrtarëve publikë detyrimet kryesore dhe t'i nxisin të konsultojnë ligjin, duke iu kërkuar që të plotësojnë një test të thjeshtë në internet në baza vjetore në lidhje me çështje të konfliktit të interesit.
9. Agjencia kundër Korrupsionit duhet ta përditësojë këtë udhëzues në të ardhmen, duke shtuar lloje të reja dhe të rëndësishme të konfliktit të interesit që dalin nga praktika, si dhe duke e përshtatur në përputhje me ndryshimet e mundshme të ligjit.

## 12. BIBLIOGRAFIA

Kodi nr. 06/L-074 Kodi Penal (Gazeta Zyrtare (GZ) 2/2019);

Këshilli i Evropës (2017), Udhëzues mbi Konfliktin e Interesit për Drejtuesit e Organizatave Publike, Projekti “Kontrolli i korrupsionit nëpërmjet zbatimit të ligjit dhe parandalimit (CLEP)”, Republika e Moldavisë;

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (2018), Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik (në gjuhën shqipe), gjendet në <https://krpp.rks-gov.net/>;

Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen lokale (GZ 28/2008);

Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil (GZ 72/2010);

Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (GZ 18/2011);

Ligji nr. 04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë (GZ 16/2011);

Ligji nr. 04/L-057 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare (GZ 14/2011);

Ligji nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (GZ 5/2018);

Agjencia Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit e Ukrainës (2017), Rekomandimet Metodologjike për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konfliktit të Interesit;

OECD (2005), Menaxhimi i Konfliktit të Interesit në Sektorin Publik, Udhëzues, Publikim nga OECD. Gjendet në [www.oecd.org/](http://www.oecd.org/);

Rregullorja (QRK) - nr. 04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil.

### 13. LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari për informim rreth konfliktit të interesit që ka ndodhur ose mund të ndodhë;

Shtojca 2. Formulari për deklarimin e konfliktit të interesit;

Shtojca 3. Formulari për deklarimin e interesave private në regjistrin e brendshëm të institucionit;

Shtojca 4. Formulari për informim rreth transferimit të të drejtave të ndërmarrjes;

Shtojca 5. Formulari për njoftim për përpjekjen për të ndikuar / ushtrimin e ndikimit në vullnetin e zyrtarit.



**Shtojca 1. Formulari për informim rreth konfliktit të interesit që ka ndodhur ose mund të ndodhë**

*Stema e institucionit  
Emërtimi i institucionit  
Adresa e institucionit*

**INFORMACION PËR KONFLIKTIN E INTERESIT**

Zyrtari Z./Znj.: \_\_\_\_\_

Pozita zyrtare: \_\_\_\_\_

Punëdhënësi/institucioni: \_\_\_\_\_

Nnë pajtim me nenin 8 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e Funkcionit Publik, njoftoj se ka ndodhur/mund të ndodhë konflikt ndërmjet detyrës sime zyrtare dhe interesit tim privat (*nënvizo të duhurin*).

Përshkrimi i detyrave të mia zyrtare që janë/mund të jenë ndikuar:

Përshkrimi i interesit tim privat që ndikon/mund të ndikojë në detyrat zyrtare:

Masat që kam ndërmarrë për administrimin e konfliktit të interesit:

*Nëse është e nevojshme, përdorni fletë shtesë për të përshkruar detyrat zyrtare, interesat private dhe masat e ndërmarra. Nënshkruani secilën fletë.*

\_\_\_ (numri) i fletës(ëve) të shtuara si shtojcë(a) të këtij njoftimi.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

## Shtojca 2: Formulari për deklarimin e konfliktit të interesit

Stema e institucionit  
Emërtimi i institucionit  
Adresa e institucionit

### DEKLARIMI I KONFLIKTIT TË INTERESIT

Zyrtari Z./Znj.: \_\_\_\_\_

Pozita zyrtare: \_\_\_\_\_

Punëdhënësi/institucioni: \_\_\_\_\_

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, deklaroj se interesi im privat/interesi privat i një të afërmit tim (*nënvizo të duhurin*) mund të shkaktojë konflikt interesi në vendimmarrje.

Vendimi zyrtar që mund të ndikohet nga interesi privat:

Detyrat e mia zyrtare në çështjen e vendimmarrjes:

Interesi privat që mund të ndikojë në vendim (*në rast të një interesi të një të afërmi, emri/pozita e personit dhe marrëdhënia ime me personin*):

Masat që kam ndërmarra për të administruar konfliktin e interesit.


*Nëse është e nevojshme, përdorni fletë shtesë për të përshkruar vendimmarrjen, detyrat zyrtare, interesat private dhe masat e ndërmarra. Nënshkruani secilën fletë.*

\_\_\_\_ (numri) i fletës(ëve) të shtuara si shtojcë(a) të këtij njoftimi.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

**Shtojca 3: Formulari për deklarimin e interesave private në regjistrin e brendshëm të institucionit**

*Stema e institucionit  
Emërtimi i institucionit  
Adresa e institucionit*

**DEKLARATA E INTERESAVE PRIVATE**

Zyrtari Z./Znj.: \_\_\_\_\_

Pozita zyrtare: \_\_\_\_\_

Punëdhënësi/institucioni: \_\_\_\_\_

Me anë të këtij formulari, ofroj informacion për interesat e mia private, për t'u përdorur në pajtim me nenin 19, paragrafi 2 dhe nenin 20, paragrafët 4 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e Funkzionit Publik.

Personat fizikë të afërm me mua sipas nenit 3, nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkzionit Publik:

Nr.	Emri dhe mbiemri	Nr. i letënjoft.	Adresa	Marrëdhënia me mua
1				
2				
3				
4				
...				

Subjektet juridike në lidhje me mua sipas nenit 3, nënparagrafi 1.6 i Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkzionit Publik dhe nenit 417, paragrafi 5 të Kodit Penal nr. 06/L-074:

Nr.	Titulli	Nr i regjistrimit	Adresa	Marrëdhënia me mua apo me një anëtar të familjes sime
1				
2				
3				
4				
...				

Persona të tjerë, përveç atyre të renditur më sipër, nga të cilët unë ose ndonjë anëtar i familjes sime ka marrë ndonjë lloj të ardhure gjatë 12 muajve të mëparshëm ose pret të marrë ndonjë lloj të ardhure gjatë 12 muajve të ardhshëm.

*(Pritshmëria përfshin mes të tjerash marrëveshjet dhe kontratat e lidhura, të drejtat e pronësisë, të cilat mund të rezultojnë në të ardhura).*

Nr.	Emri, mbiemri / pozita	Nr i regjistrimit/i letërnjoftimit	Adresa	Shuma e pranuar	Lloji i të ardhurave*	Shume e pritshme	Lloji i të ardhurave*
1							
2							
3							
...							

\* Paga, të ardhurat nga qiraja ose shitja, fitime kapitale, etj.

Interesat e tjera private, siç përcaktohet në nenin 3, nënparagrafi 1.2 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, të cilat dëshiroj t'i theksoj dhe duhet të merren parasysh për të shmangur një konflikt interesi.

Nr.	Lloji i interesit	Sipas rastit, personat me të cilat ndërlidhet interesi privat dhe marrëdhënia ime me personin / personat
1		
2		
3		
....		

*Nëse është e nevojshme, përdorni fletë shtesë për të dhënë informacionin e kërkuar. Nënshkruani secilën fletë.*

\_\_\_\_ (numri) i fletës(ëve) të shtuara si shtojcë(a) të këtij njoftimi.

Deklaroj në mirëbesim se informacioni i paraqitur më sipër është, sipas dijenisë sime, i sinqertë dhe , i plotë.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

#### Shtojca 4. Formulari për informim rreth transferimit të të drejtave të ndërmarrjes

Stema e institucionit  
Emërtimi i institucionit  
Adresa e institucionit

### INFORMACION RRETH TRANSFERIMIT TË TË DREJTAVE TË NDËRMARRJES

Përdorni formular të veçantë për secilën ndërmarrje të drejtat qeverisëse të së cilës janë transferuar.

Zyrtari Z./Znj.: \_\_\_\_\_

Pozita zyrtare: \_\_\_\_\_

Punëdhënësi/institucioni: \_\_\_\_\_

Në pajtim me nenin 15, paragrafin 3 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, e informoj Agjencinë kundër Korrupsionit për transferimin e të drejtave qeverisëse të ndërmarrjes ku kam në pronësi aksione/pjesë të kapitalit.

Informacion për ndërmarrjen	
Emërtimi:	
Forma ligjore:	
Numri i regjistrimit:	
Adresa ligjore:	
Adresa aktuale (nëse është e ndryshme):	
Informacion për aksione/pjesë të kapitalit në pronësi	
Numri i aksioneve / përqindja e pjesëve të kapitalit në pronësinë time:	
Informacion për personin e besuar	
Emërtimi:	
ID / numri i regjistrimit:	
Adresa ligjore:	

Adresa aktuale (nëse është e ndryshme):	
Telefoni:	
E-mail:	
<b>Dokumenti(et) e bashkëngjitur si dëshmi e transferimit</b>	
Titulli(titujt) e dokumentit(eve)	

\_\_\_ (numri) i dokumentit(eve) të shtuara si shtojcë(a) të këtij njoftimi.

Deklaroj se personi i besuar është në pajtim me kërkesat e parashtruara në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik. Publik.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

**Shtojca 5. Formulari për njoftim për përpjekjen për të ndikuar / ushtrimin e ndikimit në vullnetin e zyrtarit**

*Stema e institucionit  
Emërtimi i institucionit  
Adresa e institucionit*

**NJOFTIM PËR PËRPJEKJEN PËR TË NDIKUAR / USHTRIMIN E NDIKIMIT NË VULLNETIN E ZYRTARIT (nënvizo të duhurin)**

Zyrtari Z./Znj.: \_\_\_\_\_

Pozita zyrtare: \_\_\_\_\_

Punëdhënësi/institucioni: \_\_\_\_\_

Në pajtim me nenin 16, paragrafin 1 dhe 2 (nënvizo të duhurin) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ju njoftoj se:

( ) Janë bërë përpjekje për të ndikuar në vullnetin tim.

( ) Kam qenë subjekt i ndikimit për të votuar ose për të marrë vendim.

*Vendos (X) aty ku duhet.*

Hollësitë e identitetit të personit(ave) që kanë bërë përpjekje për / kanë ushtruar ndikim:

Përshkrimi i mënyrës se si është bërë përpjekja / ushtrimi i ndikimit dhe rrethanat në të cilat është bërë:

Përshkrimi i përparësisë së paligjshme / dhuratës në fjalë (nëse ka pasur dhuratë) dhe vlera e saj (nëse nuk e dini me saktësi, vendosni vlerën e hamendësuar):

Hollësitë për dëshmitarët (nëse ka):

Masat që keni ndërmarrë në përgjigje të përpjekjeve për ndikim / ndikimit të ushtruar:

*Nëse është e nevojshme, përdorni fletë shtesë për të dhënë informacionin e kërkuar. Nënshkruani secilën fletë.*

\_\_\_\_ (numri) i fletës(ëve) të shtuara si shtojcë(a) të këtij njoftimi.

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_





Ky udhëzues është hartuar për t'iu ardhur në ndihmë zyrtarëve në mënyrë që ata të veprojnë në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Udhëzuesi përmban hapat, procedurat dhe përgjegjësitë për zgjidhjen e situatave të konfliktit të interesit në institucione.

Shpjegimet dhe udhëzimet e këtij udhëzuesi vlejnë së pari për zyrtarët që në kompetencat e tyre profesionale nuk kanë parësore luftën kundër korrupsionit dhe legjislacionin për konfliktin e interesit. Ato përfaqësojnë një burim të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u përdorur si referim.

Udhëzuesi shpjegon termat kryesorë, si konflikti real, i mundshëm dhe në dukje i interesit, interesi privat pasuror dhe jopasuror, apo personi i afërm me zyrtarin

Ky udhëzues ndalet edhe te detyrimet e zyrtarëve në lidhje me dhuratat, kur përballen me përpjekjet për ndikim apo ushtrim ndikimi në vullnetin e tyre, te kërkesat për zyrtarët e lartë që të transferojnë të drejta administrimi apo drejtimi të ndërmarreve dhe te kufizimet në periudhën pas përfundimit të funksionit publik.

[www.coe.int/peck2](http://www.coe.int/peck2)

ALB

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse për të drejtat e njeriut në kontinent. Ajo përfshin 47 shtete anëtare, 28 prej të cilave janë anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i përcaktuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Bashkimi Evropian është një partneritet unik ekonomik dhe politik në mes të 28 vendeve demokratike evropiane. Ai synon paqen, begatinë dhe lirinë për 500 milionë qytetarët e tij në një botë më të drejtë dhe më të sigurtë. Për t'i bërë këto të mundshme, vendet e BE-së kanë themeluar organe për ta drejtuar BE-në dhe miratuar legjislacionin e tij. Më kryesoret janë Parlamenti Evropian (që përfaqëson popullin e Evropës), Këshilli i Bashkimit Evropian (që përfaqëson qeveritë kombëtare) dhe Komisioni Evropian (që përfaqëson interesat e përbashkëta të BE-së).

[www.coe.int](http://www.coe.int)



EUROPEAN UNION



CONSEIL DE L'EUROPE